



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

---

**RREGULLORE Nr. 02/2011**  
**PËR FUSHAT E PËRGJEGJËSISË ADMINISTRATIVE TË ZYRËS SË KRYEMINISTRIT DHE**  
**MINISTRIVE**

**REGULATION No. 02/2011**  
**ON THE AREAS OF ADMINISTRATIVE RESPONSIBILITY OF THE OFFICE OF THE PRIME**  
**MINISTER AND MINISTRIES**

**PRAVILNIK Br. 02/2011**  
**O OBLASTIMA ADMINISTRATIVNE ODGOVORNOSTI KANCELARIJE PREMIJERA I**  
**MINISTARSTAVA**



<p>Qeveria e Republikës së Kosovës,</p> <p>Në mbështetje të nenit 93 (4) dhe nenit 96 (1 dhe 2) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, dhe nenit 22 (2) të Ligjit nr. 03/L-189 për administratën shtetërore të Republikës së Kosovës,</p> <p>Duke marrë parasysh Vendimin (nr. 04-V-05) e Kuvendit të Republikës së Kosovës, të mbledhjes plenare të mbajtur më 22 shkurt 2011, për zgjedhjen e Kryeministrit, të zëvendëskryeministrave dhe të ministrave të Qeverisë së Republikës së Kosovës, si dhe në pajtim me nenin 4 (3) të Rregullores së Punës së Qeverisë Nr. 01/2007,</p> <p>Nxjerr:</p> <p style="text-align: center;"><b>RREGULLORE</b> <b>Nr. 02/2011</b></p> <p style="text-align: center;"><b>PËR FUSHAT E PËRGJEGJËSISË</b> <b>ADMINISTRATIVE TË ZYRËS SË</b> <b>KRYEMINISTRIT DHE MINISTRIVE</b></p>	<p>Government of the Republic of Kosovo,</p> <p>Pursuant to Article 93 (4) and Article 96 (2) of Constitution of the Republic of Kosovo, and Article 22 (2) of Law nr.03/L-189 on State Administration of the Republic of Kosovo,</p> <p>Considering Decision (nr. 04-V-05) of the Assembly of the Republic of Kosovo, of the plenary meeting held on 22 February 2011, to appoint the Prime Minister, Deputy Prime Ministers and Ministers of the Government of the Republic of Kosovo,</p> <p>in accordance with Article 4 (3) of the Rules of Procedures of the Government Nr. 01/2007,</p> <p>Promulgate:</p> <p style="text-align: center;"><b>REGULATION</b> <b>No. 02/2011</b></p> <p style="text-align: center;"><b>ON THE AREAS OF</b> <b>ADMINISTRATIVE</b> <b>RESPONSIBILITY OF THE OFFICE</b> <b>OF THE PRIME MINISTER AND</b> <b>MINISTRIES</b></p>	<p>Vlada Republike Kosova</p> <p>Na osnovu člana 93 (4) i člana 96 (2) Ustava Republike Kosova, i člana 22 (2) Zakona br. 03/L-189 o državnoj upravi Republike Kosovo</p> <p>Imajući u vidu Odluku (br. 04-V-05) Skupštine Republike Kosova, sa plenarne sednice održane 22. februara 2011, o imenovanju premijera, zamenika premijera i Vlade Republike Kosovo i</p> <p>u skladu sa članom 4 (3) Poslovnika o radu Vlade br. 01/2007,</p> <p>Donosi:</p> <p style="text-align: center;"><b>PRAVILNIK</b> <b>Br. 02/2011</b></p> <p style="text-align: center;"><b>O OBLASTIMA</b> <b>ADMINISTRATIVNE</b> <b>ODGOVORNOSTI KANCELARIJE</b> <b>PREMIJERA I MINISTARSTAVA</b></p>
---	--	--



<p><b>KREU I: DISPOZITAT E PËRGJITHSHME</b></p> <p style="text-align: center;"><b>Neni 1 Qëllimi dhe fushëveprimi</b></p> <p>1. Kjo rregullore përcakton:</p> <p>1.1. fushat e përgjegjësisë dhe numrin e autoriteteve të larta të administratës shtetërore, si dhe</p> <p>1.2. fushat e përgjegjësisë dhe numrin e organeve të larta të administratës shtetërore.</p> <p style="text-align: center;"><b>Neni 2 Përkufizimet</b></p> <p>1. Shprehjet e përdorura në këtë rregullore kanë këtë kuptim:</p> <p>1.1. <b>Autoritetet e larta të administratës shtetërore</b> - Qeverinë si tërësi, Kryeministrin, zëvendëskryeministrat dhe ministrat.</p> <p>1.2. <b>Organet e larta të administratës shtetërore</b> - Zyra e Kryeministrit dhe Ministrisë.</p>	<p><b>CHAPTER 1: GENERAL PROVISIONS</b></p> <p style="text-align: center;"><b>Article 1 Purpose and Scope</b></p> <p>1. The present Regulation determines:</p> <p>1.1. fields of responsibilities and the number of higher authorities of state administration;</p> <p>1.2. the fields of responsibilities and the number of higher bodies of the state administration</p> <p style="text-align: center;"><b>Article 2 Definitions</b></p> <p>1. Terms used in this regulation have the following meaning:</p> <p>1.1. <b>Higher Authorities of State Administration</b> – Government in general, Prime Minister, Deputy Prime Ministers and Ministers.</p> <p>1.2. <b>Higher Bodies of State Administration</b> – Office of the Prime Minister and Ministries.</p>	<p><b>I. POGLAVLJE: OPŠTE ODREDBE</b></p> <p style="text-align: center;"><b>Član 1 Namena i delokruga</b></p> <p>1. Ova odredba utvrđuje:</p> <p>1.1. oblasti odgovornosti i broj najviših autoriteta državne uprave, kao i</p> <p>1.2. oblasti odgovornosti i broj organa državne administracije.</p> <p style="text-align: center;"><b>Član 2 Definicije</b></p> <p>1. Izrazi upotrebljeni u ovoj uredbi imaju sledeće značenje:</p> <p>1.1. <b>Visoki autoriteti državne uprave</b> - Vlada u celini, Premijer, zamenik premijera i ministri.</p> <p>1.2. <b>Visoki organi državne uprave</b>- Kancelarija premijera i ministarstva.</p>
--	---	---



<b>KREU II: AUTORITETET E LARTA TË ADMINISTRATËS SHETËRORE</b>	<b>CHAPTER II: HIGHER AUTHORITIES OF STATE ADMINISTRATION</b>	<b>II POGLAVLJE - VISOKI AUTORITETI DRŽAVNE UPRAVE</b>
<p style="text-align: center;"><b>Neni 3 Autoritetet e larta të administratës shtetërore</b></p> <p>1. Qeveria në tërësi, Kryeministri, zëvendëskryeministrat dhe ministrat janë autoritetet e larta të administratës shtetërore.</p> <p>2. Autoritetet e larta të administratës shtetërore udhëheqin dhe mbikëqyrin administratën shtetërore në fushat e tyre përkatëse të përgjegjësisë.</p>	<p style="text-align: center;"><b>Article 3 Higher Authorities of State Administration</b></p> <p>1. The entire composition of the Government, Prime Minister, Deputy Prime Ministers and Ministers are the highest authorities of state administration.</p> <p>2. Higher Authorities of State Administration shall guide and monitor the state administration in their respective areas of responsibility.</p>	<p style="text-align: center;"><b>Član 3 Visoki autoriteti državne uprave</b></p> <p>1. Vlada u celini, Premijer, zamenici premijera i ministri su najviši autoriteti državne uprave.</p> <p>2. Visoki autoriteti državne uprave upravljaju i nadziru državnom upravom u svojim oblastima odgovornosti.</p>
<p style="text-align: center;"><b>Neni 4 Qeveria</b></p> <p>1. Qeveria ushtron pushtetin e vet ekzekutiv në përputhje me Kushtetutën dhe legjislacionin në fuqi që ka të bëjë me Qeverinë.</p> <p>2. Qeveria me qëllim të ushtrimit të kompetencave të përcaktuara me Kushtetutën dhe legjislacionin në fuqi:</p> <p>2.1. merr vendime me propozimin e autoriteteve të larta të</p>	<p style="text-align: center;"><b>Article 4 Government</b></p> <p>1. Government shall exercise its executive power in accordance with Constitution and legislation in force dealing with the Government.</p> <p>2. Government in order to exercise its competences determined by the Constitution and legislation in force:</p> <p>2.1. makes decisions on the proposal of the higher authorities of</p>	<p style="text-align: center;"><b>Član 4 Vlada</b></p> <p>1. Vlada izvršava svoju izvršnu vlast u skladu sa Ustavom i važećim zakonima koji se odnose na Vladu.</p> <p>2. Vlada u cilju ostvarivanja nadležnosti propisanih Ustavom i važećim zakonima:</p> <p>2.1. donosi odluke na predlog najviših autoriteta državne uprave;</p>



<p>administratës shtetërore;</p> <p>2.2. nxjerr akte juridike ose rregullore, të nevojshme për zbatimin e ligjeve;</p> <p>2.3. diskuton probleme ose çështje të tjera që ajo i konsideron të rëndësishme në kuadër të kompetencave të veta;</p> <p>2.4. vendosë për emërimet dhe shkarkimet brenda kompetencave të veta, si dhe</p> <p>2.5. kryen të gjitha detyrat dhe përgjegjësitë e përcaktuara me Kushtetutë dhe legjislacionin tjetër në fuqi.</p> <p style="text-align: center;"><b>Neni 5</b> <b>Anëtarët/et e Qeverisë</b></p> <p>1. Anëtarët/et e Qeverisë:</p> <p>1.1. mbështesin punën e Qeverisë;</p> <p>1.2. kanë të drejtë të ngrenë iniciativë për përgatitjen e projektligjeve si dhe të propozojnë politika, që kanë të bëjnë me ministritë e tyre përkatëse.</p> <p>1.3. që janë të caktuar të marrin pjesë në punën e organeve dhe të komisioneve të tjera, veprojnë sipas</p>	<p>state administration;</p> <p>2.2. issues legal acts or regulation, necessary for the implementation of laws;</p> <p>2.3. discuss problems or other issues that it considers important within the frame of its competency;</p> <p>2.4. decide on appointments and dismissals within its competency, and</p> <p>2.5. performs all duties and responsibilities set forth in the Constitution and legislation in force.</p> <p style="text-align: center;"><b>Article 5</b> <b>Member/s of Government</b></p> <p>1. Member/s of Government:</p> <p>1.1. support the work of the Government;</p> <p>1.2. have rights to launch the initiative for preparation of draft laws and to propose policies, relating to their respective Ministries.</p> <p>1.3. that are assigned to participate in the work of bodies and other commissions, and shall</p>	<p>2.2. donosi pravna akta ili propise neophodne za sprovođenje zakona;</p> <p>2.3. razmatra probleme ili druga pitanja, koje ona smatra važnim u okviru svoje nadležnosti;</p> <p>2.4. odlučuje o imenovanjima i razrešenjima u okviru svoje nadležnosti, kao i</p> <p>2.5. obavlja sve dužnosti i odgovornosti utvrđene Ustavom i drugim zakonima na snazi.</p> <p style="text-align: center;"><b>Član 5</b> <b>Članovi Vlade</b></p> <p>1. Članovi/ce Vlade:</p> <p>1.1. Podržavaju rad Vlade;</p> <p>1.2. imaju pravo da podnose inicijativu za pripremu nacрта zakona i predlažu politiku koja se odnosi na njihova relevantna ministarstva.</p> <p>1.3. koji su određeni da učestvuju u radu organa i drugih komisija, postupaju u okviru ovlašćenja, ciljeva i stavova Vlade</p>
--	---	---



<p>autorizimeve, objektivave dhe qëndrimeve të Qeverisë në përputhje me Kushtetutën dhe ligjin.</p>	<p>act according to the authorities, objectives and attitudes of the Government in accordance with the Constitution and the Law.</p>	<p>u skladu sa Ustavom i zakonom.</p>
<p style="text-align: center;"><b>Neni 6 Kryeministri</b></p>	<p style="text-align: center;"><b>Article 6 Prime Minister</b></p>	<p style="text-align: center;"><b>Član 6 Premijer</b></p>
<p>1. Kryeministri ushtron pushtetin e vet ekzekutiv në përputhje me Kushtetutën dhe legjislacionin tjetër në fuqi.</p> <p>2. Kryeministri përfaqëson dhe udhëheq Qeverinë:</p> <p>3. Kryeministri:</p> <p>3.1. në emër të Qeverisë, koncepton, propozon dhe zbaton drejtimet kryesore të politikës shtetërore dhe përgjigjet për to;</p> <p>3.2. bashkërendon dhe kontrollon punën e anëtarëve të Qeverisë;</p> <p>4. Në zbatim të kompetencave të tij Kushtetuese, Kryeministri, mund:</p> <p>4.1. të nxjerr vendime, urdhra, rregullore dhe lidh marrëveshje mirëkuptimi/bashkëpunimi;</p> <p>4.2. të kërkojë nga çdonjëri prej</p>	<p>1. Prime Minister exercises his executive power in accordance with the Constitution and legislation in force.</p> <p>2. Prime Minister represents and leads the Government:</p> <p>3. Prime Minister:</p> <p>3.1. on behalf of the Government, conceive, propose and implement the main directions of state policy and is responsible for them;</p> <p>3.2. coordinates and monitor the work of members of the Government:</p> <p>4. Pursuant to its Constitutional powers, Prime Minister, may:</p> <p>4.1. issue decisions, orders, regulations and establish memorandums of understanding/cooperation;</p> <p>4.2. require from an individual</p>	<p>1. Premijer obavlja svoju izvršna ovlašćenja u skladu sa Ustavom i drugim važećim zakonodavstvom.</p> <p>2. Premijer predstavlja i upravlja Vladom:</p> <p>3. Premijer:</p> <p>3.1. u ime Vlade, konceptira, predlaže i sprovodi glavne pravce državne politike i odgovora za nju;</p> <p>3.2. koordinira i nadzire rad članova Vlade;</p> <p>4. U skladu sa svojim ustavnim ovlašćenjima, premijer može da:</p> <p>4.1. donosi odluke, naredbe, propise i sklapa Memorandume o razumevanju/saradnju;</p> <p>4.2. zahteva od bilo kog zamenika</p>



<p>zëvendëskryeministrave dhe ministrave t'i raportojë me gojë apo me shkrim për punën e tij/saj dhe të ministrisë të cilën e kryeson, që t'i ofrojë informata dhe raporte nga fusha e vet e punës si dhe informata të tjera me rëndësi për mbarëvajtjen e punës së Qeverisë;</p> <p>4.3. menjëherë, ose jo më vonë se në mbledhjen e ardhshme të Qeverisë, të kërkojë që Qeveria ta rishqyrtojë dhe ta ndryshojë vendimin e saj, nëse Kryeministri vlerëson se vendimi i marrë nga Qeveria mund të ketë pasoja të dëmshme. Zbatimi i këtij vendimi pezullohet derisa Qeveria ta trajtojë kërkesën e Kryeministrit;</p> <p>4.4. të kërkojë shpjegime dhe verifikime administrative, prej zëvendëskryeministrave dhe ministrave përgjegjës për çështje të fushës që ata/ato mbulojnë;</p> <p>4.5. t'i raportojë Kuvendit në mënyrë periodike, ndërsa me kërkesë të Kuvendit, të raportojë për aktivitetet e Qeverisë apo të ministrisë së caktuar, duke përfshirë shfrytëzimin e të gjitha fondeve të</p>	<p>Deputy Prime Minister and Ministers to report to him orally or in writing on his/her work and on the work of the Ministry which he heads, to provide him with information and reports on his area of work and other information important for the running of the Government;</p> <p>4.3. immediately, or no later than at the subsequent meeting of the Government, shall require the Government to review and amend its decision, if Prime Minister considers that the decision taken by the Government may have damaging consequences. Implementation of this Decision is suspended until the Government shall handle the request of the Prime Minister;</p> <p>4.4. require explanations and administrative checks, from Deputy Prime Ministers and Ministers responsible for issues that they cover;</p> <p>4.5. report to the Assembly periodically, whilst with the request of the Assembly, to report on activities of the Government or the Ministry concerned, including the use of all funds received;</p>	<p>premierja i ministara da usmeno ili pismeno podnosi izveštaj o svom radu i radu ministarstva kojim upravlja, i da pruži informacije i podnosi izveštaje iz svoje oblasti rada i druge informacije značajne za rad Vlade;</p> <p>4.3. odmah ili najkasnije na narednom sastanku Vlade, zahteva Vladi da ponovo razmotri i izmeni svoju odluku, ako premijer oceni da odluka Vlade može imati štetne posledice. Sprovođenje ove odluke se suspenduje sve dok Vlada obradi zahtev premijera;</p> <p>4.4. da traži potrebna objašnjenja i administrativne provere, od zamenika premijera i ministara nadležnih za pitanja iz oblasti koje oni pokrivaju;</p> <p>4.5. da periodično podnosi izveštaj Skupštini, a na zahtev Skupštine, da podnosi izveštaj o aktivnostima Vlade ili određenih ministarstava, uključujući upotrebu svih dobijenih fondova;</p>
--	---	---



<p>pranuara;</p> <p>4.6. të sigurojë se ka komunikim efektiv të politikave dhe të aktiviteteve qeveritare për qytetarët e Republikës së Kosovës;</p> <p>4.7. të marrë përsipër, me miratimin e Qeverisë, edhe detyra të tjera, në pajtim me Kushtetutën dhe ligjin;</p> <p>4.8. të nënshkruajë të gjitha aktet juridike të aprovuara nga Qeveria dhe siguron zbatimin e tyre.</p> <p>4.9. zgjidh mosmarrëveshjet ndërmjet ministrave/eve.</p> <p style="text-align: center;"><b>Neni 7</b> <b>Zëvendëskryeministrat</b></p> <p>1. Zëvendëskryeministri/ja(at/et), gjatë ushtrimit të funksioneve:</p> <p>1.1. ndihmojnë Kryeministrin/en në caktimin e prioriteteve, në zhvillimin dhe zbatimin e politikave të Qeverisë;</p> <p>1.2. me autorizim të Kryeministrit marrin pjesë në hartimin e vendimeve dhe të akteve</p>	<p>4.6. ensure that there is effective an communication of Government policies and activities for citizens of the Republic of Kosovo;</p> <p>4.7. take over, with the approval of the Government, other duties as well, in accordance with the Constitution and the Law.</p> <p>4.8. sign all legal acts adopted by the Government and ensures their implementation.</p> <p>4.9. resolve disagreements between Ministers.</p> <p style="text-align: center;"><b>Article 7</b> <b>Deputy Prime Ministers</b></p> <p>1. Deputy Prime Minister/s while performing his/her/their functions:</p> <p>1.1. assist the Prime Minister in determining priorities, development and implementation of Government policies;</p> <p>1.2. with the authorization of the Prime Minister participates in drafting decisions and other acts,</p>	<p>4.6. da obezbediti postojanje efikasna komunikacije vladine politike i aktivnosti za građane Kosova.</p> <p>4.7. da preuzima, uz saglasnost Vlade, i druge poslove u skladu sa Ustavom i zakonor;</p> <p>4.8. da potpisuje sva pravna akta koje je usvojila Vlada i obezbeđuje njihovo sprovođenje;</p> <p>4.9. rešava neslaganja među ministrima/arkama.</p> <p style="text-align: center;"><b>Član 7</b> <b>Zamenici premijera</b></p> <p>1. Zamenik premijera/ca (i), u vršenju funkcija:</p> <p>1.1. pomažu premijeru u utvrđivanju prioriteta, u razvoju i implementaciji politike Vlade;</p> <p>1.2. po ovlašćenju Premijera učestvuju u izradi odluka i drugih akata koji regulišu rad kabineta</p>
--	---	---





<p>të tjera, që rregullojnë aktivitetet e Kabinetit të Kryeministrit dhe të Qeverisë;</p> <p>1.3. në bashkërendim me Kryeministrin i mbikëqyrin aktivitetet e organeve operative të Qeverisë dhe sigurojnë zbatimin e përgjegjësive dhe të funksioneve të cilat u janë besuar organeve të tilla;</p> <p>1.4. zëvendësojnë Kryeministrin në rast të mungesës;</p> <p>1.5. ushtrojnë detyra të tjera, të cilat u caktohen nga Kryeministri;</p> <p>1.6. me autorizim të Kryeministrit, mund të marrin përgjegjësi që i janë dhënë Kryeministrit;</p> <p>1.7. kryejnë detyra të tjera që përcaktohen me ligje të veçanta.</p> <p>2. Zëvendëskryeministri/ja(at/et)janë përgjegjës për një fushë me rëndësi të veçantë dhe prioritet të lartë për Qeverinë por mund të përfshijë koordinimin e një fushe të politikave që është në kuadër të përgjegjësisë së disa ministrive.</p>	<p>regulating the activities of the Cabinet of Prime Minister and the Government;</p> <p>1.3. in coordination with the Prime Minister shall monitor the operation activities of the Government bodies and ensure implementation of the responsibilities and functions which were entrusted to such bodies;</p> <p>1.4. replace the Prime Minister in case of absence;</p> <p>1.5. perform other duties assigned by the Prime Minister;</p> <p>1.6. with the authorization of the Prime Minister, may take the responsibility given to the Prime Minister;</p> <p>1.7. perform other duties prescribed by special laws.</p> <p>2. Deputy Prime Minister/s is/are responsible for a special importance area and high priority for the Government but may include coordination of a policy area that is within the responsibility of several ministries.</p>	<p>premierja i Vlade;</p> <p>1.3. u koordinaciji sa Premijerom nadgledaju aktivnosti operativnih organa Vlade i obezbeđuju sprovođenje odgovornosti i funkcije koje su poverene takvim telima;</p> <p>1.4. Zamenjuje Premijera u njegovoj odsutnosti;</p> <p>1.5. Obavljaju i druge poslove koje im određuje premijer;</p> <p>1.6. Zamenik/ci premijera(ca), po ovlašćenju Premijera, mogu preuzeti odgovornosti koje su date premijeru;</p> <p>1.7. obavljaju i druge poslove propisane posebnim zakonima.</p> <p>2. Zamenik premijera (ci) su odgovorni za područje od posebnog značaja i visokog prioriteta za Vladu, ali mogu uključiti i koordinaciju jedne oblasti politike koja je u nadležnosti više ministarstava.</p>
--	---	---



<p>3. Secilit zëvendëskryeministër mund t'i epet mandati për një ministri.</p> <p>4. Zëvendëskryeministri i cili është përgjegjës për një ministri duhet t'i mbajë dy sferat e përgjegjësisë të veçanta në aspektin e brendshëm dhe të jashtëm.</p> <p>5. Zëvendëskryeministri i parë koordinon punën me zëvendëskryeministrat dhe i raporton Kryeministrit.</p> <p>6. Fushat e përgjegjësisë së zëvendëskryeministrit të parë dhe të zëvendëskryeministrave apo mandate për një ministri mund të përcaktohen me vendim të Kryeministrit.</p> <p style="text-align: center;"><b>Neni 8 Ministrat/et</b></p> <p>1. Secili ministër/re, në pajtim me direktivat dhe politikat e përcaktuara nga Qeveria:</p> <p>1.1. udhëheq dhe përfaqëson ministrinë;</p> <p>1.2. i përgjigjet Kryeministrit/es dhe Kuvendit për çështjet që kanë të bëjnë me ministrinë e tij/saj;</p>	<p>3. May be given a mandate for a Ministry to each Deputy Prime Minister.</p> <p>4. Deputy Prime Minister who is responsible for a Ministry should hold two separate spheres of responsibility in terms of internal and external.</p> <p>5. First Deputy Prime Minister shall coordinate the work with Deputy Prime Ministers and shall report to the Prime Minister.</p> <p>6. Areas of responsibility of the First Deputy Prime Minister and Deputy Prime Ministers or mandates for a Ministry may be determined by a decision of the Prime Minister.</p> <p style="text-align: center;"><b>Article 8 Ministr/s</b></p> <p>1. Each Minister, in accordance with directives and policies set by the Government:</p> <p>1.1. leads and presents the Ministry;</p> <p>1.2. respond to the Prime Minister and the Assembly on issues relating to his/her Ministry;</p>	<p>3. Svakom zameniku premijera se može dati mandat za jedno ministarstvo.</p> <p>4. Zamenik premijera, koji je odgovoran za neko ministarstvo treba snositi dve odvojene sfere odgovornosti sa unutrašnjeg i spoljnog aspekta.</p> <p>5. Prvi –zamenik premijera koordiniše rad i podnosi izveštaj Premijeru.</p> <p>6. Oblasti odgovornosti prvog zamenika premijera i zamenika premijera ili mandati za jedno ministarstvo se mogu odrediti odlukom premijera.</p> <p style="text-align: center;"><b>Član 8 Ministri/ke</b></p> <p>1. Svaki ministar/ka, u skladu sa direktivama i politikama koje je postavila Vlada:</p> <p>1.1. Upravlja i zastupa ministarstvo;</p> <p>1.2. Odgovoran je premijeru i Skupšini o pitanjima koja se tiču njegovog/njenog ministarstva;</p>
---	---	---



<p>1.3. propozon projektligje nga fushëveprimi i ministrisë dhe përcakton orientimin politik të punës së ministrisë;</p> <p>1.4. nxjerr vendime dhe akte nënligjore dhe mund të lidhë marrëveshje mirëkuptimi/bashkëpunimi, në mënyrë që t'i rregullojë aktivitetet e ministrisë në përgjithësi ose në fushat e veçanta të ministrisë përkatëse dhe</p> <p>1.5. kryen detyra të tjera në suaza të kornizës së përgjegjësive të ministrisë, të përcaktuara me legjislacionin në fuqi.</p> <p style="text-align: center;"><b>Neni 9</b> <b>Përgjegjësitë e ministrave/eve</b></p> <p>1. Gjatë kryerjes së përgjegjësive dhe funksioneve të tyre, ministrat/et kujdesen që ministritë e tyre përkatëse:</p> <p>1.1. të hartojnë dhe të mbikëqyrin zbatimin e politikave të ministrisë;</p> <p>1.2. të planifikojnë qartë buxhetin dhe të formulojnë prioritetet për ndarjen e mjeteve financiare, që i</p>	<p>1.3. propose draft laws from the scope of the Ministry and defines the political orientation of the work of Ministry;</p> <p>1.4. issue decisions and sub legal acts and may establish memorandums of understanding/cooperation, in order to regulate the activities of the ministry in general or in specific areas of the relevant Ministry and</p> <p>1.5. perform other duties within the framework responsibilities of the Ministry, determined by legislation in force.</p> <p style="text-align: center;"><b>Article 9</b> <b>Responsibilities of Ministries</b></p> <p>1. While performing their responsibilities and functions, Minister/s ensures that their respective Ministries shall:</p> <p>1.1. draft and monitor the implementation of the policy of the Ministry;</p> <p>1.2. plan the budget clearly and formulate priorities for the allocation of funds, which are available from</p>	<p>1.3. predlaže nacрте zakona iz delokruga ministarstva i postavlja političke pravce rada Ministarstva;</p> <p>1.4. donosi odluke i podzakonske akte i može sklapati memorandume o razumijevanju/saradnju, u cilju regulisanja aktivnosti ministarstva u celini ili u specifičnim oblastima nadležnog ministarstva i</p> <p>1.5. obavlja i druge poslove u okviru odgovornosti Ministarstva utvrđenih važećim zakonodavstvom.</p> <p style="text-align: center;"><b>Član 9</b> <b>Odgovornost ministara/ki</b></p> <p>1. U obavljanju svojih odgovornosti i funkcije, ministri obezbeđuju da njihova ministarstva:</p> <p>1.1. izrađuju i nadgledaju sprovođenje politike ministarstva;</p> <p>1.2. jasno planiraju budžet i da formulišu prioritete za dodelu finansijskih sredstava, koja su im</p>
---	---	--



<p>vihen në dispozicion nga Buxheti i Kosovës dhe nga burime të tjera;</p> <p>1.3. të sigurojnë ndarjen më të përshtatshme, transparente dhe të përgjegjshme të fondeve që i marrin nga Buxheti i Kosovës dhe nga burime të tjera;</p> <p>1.4. të sigurojnë shërbime të besueshme, transparente, të përgjegjshme dhe jodiskriminuese;</p> <p>1.5. të krijojnë dhe të zbatojnë masa kundër mashtrimit dhe korrupsionit, si dhe të nxisin vetëdijesimin kundër mashtrimit;</p> <p>1.6 të krijojnë dhe të aftësojnë kuadro në fushat e përgjegjësisë të tyre përkatëse.</p>	<p>Kosovo budget and other sources;</p> <p>1.3. provide the most appropriate, transparent and allocation accountable of funds received from the Kosovo budget and other sources;</p> <p>1.4. provide reliable services, transparent, accountable and non-discriminatory;</p> <p>1.5. create and implement measures against fraud and corruption and to promote fraud awareness;</p> <p>1.6 to create and train staff in their respective areas of responsibilities.</p>	<p>stavljena na raspolaganju iz budžeta Kosova i iz drugih izvora;</p> <p>1.3. obezbeđuju najprikladniju, transparentnu i odgovornu raspodelu sredstava dobijenih iz budžeta Kosova i drugih izvora;</p> <p>1.4. obezbeđuju pouzdane, transparentne, odgovorne i nediskriminatorne usluge;</p> <p>1.5. da kreiraju i sprovode mera protiv prevare i korupcije i promovišu unapređenje svesti protiv prevare;</p> <p>1.6. da stvaraju i osposoblavaju kadrove u njihovim odgovarajucim oblastima odgovornosti.</p>
<p>2. Po ashtu, Ministrat/et janë përgjegjës që:</p> <p>2.1. të marrin pjesë në mbledhjet e Qeverisë e të trupave të saja të punës, aty ku janë anëtarë/e;</p> <p>2.2. të informojnë paraprakisht Kryeministrin për vizitat jashtë vendit dhe të raportojnë me shkrim apo me gojë, jo më vonë se pesë ditë</p>	<p>2. Ministers are also responsible to:</p> <p>2.1. participate in sessions of the Government and its working bodies, where member/s;</p> <p>2.2. inform the Prime Minister and the Government in advance for their abroad visits and to report orally or in writing, at least five days ahead</p>	<p>2. Ministri su takođe odgovorni da:</p> <p>2.1 učestvuju na sastancima Vlade i njenih radnih tela, tamo gde su oni članovi/ce;</p> <p>2.2. da predhodno informišu premijera o posetaama u inostranstvu i da pismeno ili usmeno podnesu izveštaj, najkasnije u roku od pet dana nakon</p>



<p>pas realizimit të tyre;</p> <p>2.3 të njoftojnë paraprakisht Kryeministrin dhe Qeverinë si dhe Ministrin e Punëve të Jashtme për çdo nismë të ministrive për marrëveshje ndërkombëtare apo të brendshme, të njoftojnë paraprakisht Kryeministrin dhe Qeverinë për organizime të ngjarjeve të rëndësishme e të ngjashme dhe të raportojnë me shkrim, jo më vonë se pesë ditë pas mbarimit të tyre;</p> <p>2.4. të sigurojnë se politikat ministrore janë komunikuar dhe diskutuar qartë dhe efektivisht për ata për të cilët janë synuar apo kanë interes në to;</p> <p>2.5. t'i raportojnë Kryeministrit/es dhe Qeverisë në mënyrë periodike, ndërsa me kërkesë të Kryeministrit/es, të raportojnë për aktivitetet e ministrisë, duke përfshirë shfrytëzimin e të gjitha burimeve të pranuar;</p> <p>2.6. të njoftojnë Kryeministrin dhe Qeverinë për të gjitha aktet juridike të nxjerra dhe për marrëveshjet e mirëkuptimit të nënshkruara.</p> <p>3. Ministrat/et ushtrojnë edhe detyra të</p>	<p>after their implementation;</p> <p>2.3. inform the Prime Minister and the Government and the Minister of Foreign Affairs in advance on any initiative of ministries concerning any domestic or international agreement and inform the Prime Minister and the Government on, organization of important and similar events and to report in writing by no latter than five days after the event is finished;</p> <p>2.4. ensure that Ministerial policies are communicated and discussed clearly and efficiently to those who are aiming for or have interest in them;</p> <p>2.5. report to the Prime Minister and the Government periodically, while with the request of the Prime Minister, to report on activities of the Ministry, including the use of all resources received;</p> <p>2.6. notify the Prime Minister and the Government on all legal acts issued and signed agreements of memorandum of understanding.</p> <p>3. Ministers shall carry out other duties,</p>	<p>njihovog završetka;</p> <p>2.3. da predhodno informišu Premijera i Vladu kao i Ministarstvo inistranih poslova o svakoj inicijativi ministarstva za sklapanje domaćih ili međunarodnih sporazuma, da prethodno upoznaje Premijera i Vladu za organizovanje važnih događaja i pismeno izveštavaju, najkasnije pet dana posle njihovog okončanja;</p> <p>2.4. da obezbede da su ministarske politike jasno i efikasno komunicirane i diskutovane i o onome čemu se stremilo ili imaju interes u tome;</p> <p>2.5. da periodično podnose izveštaj premijeru i Vladi, a na zahtev premijera, da izveštavaju o aktivnostima Ministarstva, uključujući i upotrebu svih primljenih resursa;</p> <p>2.6 da obaveste Premijera i vladu o svim donetim pravnim aktima i potpisanim sporazumima o međusobnom razumevanju.</p> <p>3. Ministri/ake obavljaju i druge</p>
--	---	--



<p>tjera, me të cilat ngarkohen nga Qeveria ose nga Kryeministri.</p> <p>4. Fushat tjera të përgjegjësishë së ministrave mund të përcaktohen me vendim të Kryeministrit.</p> <p style="text-align: center;"><b>Neni 10</b> <b>Mungesa ose pamundësia e veprimit e Kryeministrit</b></p> <p>1. Në rast të mungesës ose pamundësisë së veprimit të Kryeministrit, ai zëvendësohet nga Zëvendës Kryeministri i parë apo në mungesë të tij të njërit prej Zëvendës Kryeministrave.</p> <p>2. Zëvendëskryeministri ushtron pushtetin dhe detyrat e tilla derisa mungesa apo paaftësia të pushojë së ekzistuari.</p> <p style="text-align: center;"><b>Neni 11</b> <b>Mungesa ose pamundësia e veprimit e një Ministri</b></p> <p>Në rast të mungesës ose pamundësisë së veprimit të ministrit, ai/ajo zëvendësohet nga zëvendësministri apo njëri prej zëvendëskryeministrave gjegjësisht njëri nga ministrat e caktuar nga Kryeministri.</p>	<p>assigned by the Government or the Prime Minister.</p> <p>4. Other areas of responsibility of Ministers may be determined by the decision of the Prime Minister.</p> <p style="text-align: center;"><b>Article 10</b> <b>The absence of the Prime Minister or his inability to act</b></p> <p>1. In case of absence of the Prime Minister or his inability to act, he is replaced by the First Deputy of the Prime Minister or in his absence of one of the Deputy Prime Ministers.</p> <p>2. Deputy Prime Minister shall exercise such power and duties until the absence or inability to cease to exist.</p> <p style="text-align: center;"><b>Article 11</b> <b>The absence or inability to act of a Minister</b></p> <p>In case of absence of a Minister or his/ her inability to act, he/she is replaced by one of Deputy Prime Ministers or one of the Ministers appointed by the Prime Minister.</p>	<p>poslove, kojima su zaduženi od strane vlade ili premijera.</p> <p>4. Ostale oblasti odgovornosti ministra se mogu odrediti odlukom premijera.</p> <p style="text-align: center;"><b>Član 10</b> <b>Odsutnost ili sprečenost delovanja premijera</b></p> <p>1. U slučaju odsustva ili nemogućnosti delovanja premijera, on se zamenjuje od strane prvog zamenika premijera ili u njegovom odsustvu jednog od zamenika premijera.</p> <p>2. Zamenik premijera izvršava ta ovlašćenja i dužnosti sve dok odsustvo ili nemogućnosti delovanja prestane.</p> <p style="text-align: center;"><b>Član 11</b> <b>Odsutnost ili sprečenost delovanja jednog Ministra</b></p> <p>U slučaju odsutnosti ili sprečenosti da deluje ministar, on / ona se zamenjuje od strane jednog od zamenika premijera ili od strane nekog od ministara koje imenuje premijer.</p>
--	---	---



<b>Neni 12</b> <b>Emërimi i zëvendësministrave</b>	<b>Article 12</b> <b>Appointment of Deputy Ministers</b>	<b>Član 12</b> <b>Imenovanje zamenika ministara</b>
<p>Zëvendësministrat emërohen nga Kryeministri për mbështetjen e ministrave. Ata/ato janë përgjegjës për menaxhimin e aktiviteteve në fushat e përcaktuara nga ministri/ja përkatës/e, si dhe për zëvendësimin e ministrit/es kur ai mungon ose kur nuk është në gjendje të kryejë detyrën e tij/saj.</p>	<p>Deputy Ministers shall be appointed by the Prime Minister to support the Ministers. They are responsible for managing the activities in the areas specified by the Minister concerned, and for replacement of the Minister when he/she is absent or when he/she is unable to perform his/her duty.</p>	<p>Zamenike ministara imenuje premijer za podršku ministrima. Oni / one su odgovorni za upravljanje aktivnostima u oblastima utvrđenim od strane relevantnog ministarstva kao i za zamenu ministra kada je odsutan ili nije u stanju da obavlja svoju dužnost.</p>
<b>Neni 13</b> <b>Zëvendësministrat/et</b>	<b>Article 13</b> <b>Deputy Minister/s</b>	<b>Član 13</b> <b>Zamenici ministra</b>
<p>1. Zëvendësministri/ja(at/et), gjatë ushtrimit të funksioneve:</p> <p>1.1. ndihmojnë ministrin/en në caktimin e prioriteteve, në zhvillimin dhe zbatimin e politikave të ministrisë;</p> <p>1.2. me autorizim të ministrit/es marrin pjesë në hartimin e vendimeve dhe të akteve të tjera, që rregullojnë aktivitetet e kabinetit të ministrit/es dhe të ministrisë;</p> <p>1.3. ushtrojnë detyra, të cilat u caktohen nga ministri/ja;</p>	<p>1. Deputy Minister while performing his/her function:</p> <p>1.1. assist the Minister in determination of priorities, development and implementation of Ministerial policies;</p> <p>1.2. with the authorization of the Minister participates in drafting decisions and other acts, regulating the activities of the Cabinet of the Minister and the Ministry;</p> <p>1.3. perform duties, assigned by the Minister;</p>	<p>1. Zamenici/ca ministra / ministara (ki), u vršenju funkcija:</p> <p>1.1. Pomažu ministru u utvrđivanju prioriteta, u razvoju i implementaciju politika Ministarstva;</p> <p>1.2. Po ovlašćenju ministra/ake učestvuju u izradi odluka i drugih akata koji regulišu rad kabineta ministra i Ministarstva;</p> <p>1.3. obavljaju zadatke koji su utvrđeni od strane Ministra;</p>



<p>1.4. zëvendësministri/ja(at/et), me autorizim të ministrit/es apo në mungesë të tij me autorizim të Kryeministrit, mund të marrin përgjegjësi që i janë dhënë ministrit/es;</p> <p>1.5. kryejnë detyra të tjera që parashikohen me ligje të veçanta.</p> <p style="text-align: center;"><b>Neni 14</b> <b>Kontesti mes Ministrit dhe zëvendësministrit</b></p> <p>1. Në rast të mosmarrëveshjes mes Ministrit dhe zëvendësministrit dhe me kërkesë të cilitdo prej tyre, Kryeministri merr vendimin përfundimtar.</p> <p>2. Zëvendës Ministri shkarkohet me vendim të Kryeministrit.</p> <p><b>Kreu 3- ORGANET E LARTA TË ADMINISTRATËS SHTETËRORE</b></p> <p style="text-align: center;"><b>Neni 15</b> <b>Organet e larta të administratës shtetërore</b></p> <p>Zyra e Kryeministrit dhe Ministrisë janë organet e larta të administratës shtetërore përmes të cilave Autoritetet e Larta të</p>	<p>1.4. Deputy Minister/s, with the authorization of the Minister or in his/her absence with the authorization of the Prime Minister, may take the responsibility given to the Minister;</p> <p>1.5. perform other duties prescribed by special laws.</p> <p style="text-align: center;"><b>Article 14</b> <b>The dispute between the Minister and Deputy Minister</b></p> <p>1. In case of a dispute between the Minister and Deputy Minister and at the request of any of them, the Prime Minister shall take final decision.</p> <p>2. Deputy Minister shall be dismissed by the decision of the Prime Minister.</p> <p><b>CHAPTER 3- HIGHER BODIES OF STATE ADMINISTRATION</b></p> <p style="text-align: center;"><b>Article 15</b> <b>Higher Bodies of State Administration</b></p> <p>Office of the Prime Minister and Ministries are the highest bodies of state administration through which the high</p>	<p>1.4. Zamenik ministra / arke, uz ovlašćenje ministra, ili u njegovom odsustvu uz ovlašćenje Premijera, mogu preuzeti odgovornosti koje su date ministru;</p> <p>1.5. obavljaju i druge poslove propisane posebnim zakonima.</p> <p style="text-align: center;"><b>Član 14</b> <b>Spor između ministra i zamenika</b></p> <p>1. U slučaju nesporazuma između ministra i zamenika ministra i na zahtev bilo kog od njih, premijer donosi konačnu odluku.</p> <p>2. Zamenik ministra se razrešava odlukom premijera.</p> <p><b>1. POGLAVLJE - VIŠI ORGANI DRŽAVNE UPRAVE</b></p> <p style="text-align: center;"><b>Član 15</b> <b>Viši organi državne uprave</b></p> <p>Kancelarija premijera i ministarstva su viši organi državne uprave kroz koje viši autoriteti državne uprave vrše svoje</p>
--	---	--





<p>Administratës Shtetërore ushtrojnë kompetencat e tyre qeveritare dhe administrative në përputhje me Kushtetutën dhe ligjin.</p>	<p>authorities of state administration shall exercises their governmental and administration competences in accordance with the Constitution and the Law.</p>	<p>upravne i administrativne nadležnosti i u skladu sa Ustavom i zakonom.</p>
<p style="text-align: center;"><b>Neni 16</b> <b>Funksionet e Zyrës së Kryeministrit</b></p>	<p style="text-align: center;"><b>Article 16</b> <b>Functions of the Office of the Prime Minister</b></p>	<p style="text-align: center;"><b>Član 16</b> <b>Funkcije Kancelarije premijera</b></p>
<p>1. Kryeministri udhëheq Zyrën e Kryeministrit.</p> <p>2. Zyra e Kryeministrit koordinon punën e gjithë ministrave/eve.</p> <p>3. Zyra e Kryeministrit ndërlidhet me Kuvendin.</p> <p>4. Zyra e Kryeministrit mbështet veprimtarinë e Kryeministrit, të Qeverisë, të zëvendëskryeministrave/eve dhe të ministrave/eve dhe është përgjegjëse për:</p> <p>4.1 Përgatitjen dhe organizimin e mbledhjeve të Qeverisë dhe mbledhjeve tjera të kryesuara nga Kryeministri ose nga një Zëvendës Kryeministër në emër të tij/saj;</p> <p>4.2 Koordinimin e marrëdhënieve mes Qeverisë dhe organeve tjera kushtetuese (Presidentit,</p>	<p>1. Prime Minister leads the Office of the Prime Minister.</p> <p>2. Prime Minister's Office coordinates the work of all ministries.</p> <p>3. Office of the Prime Minister shall liaise with the Assembly.</p> <p>4. Office of the Prime Minister supports the activities of the Prime Minister, Government, Deputy Prime Ministers and Ministers and shall be responsible for:</p> <p>4.1. Preparing and organizing government meetings and other meetings chaired by the Prime Minister or a Deputy Prime Minister on behalf of his/her;</p> <p>4.2. Coordination of relations between Government and Constitutional bodies</p>	<p>1. Premijer vodi Kancelariju Premijera.</p> <p>2. Kancelarija premijera koordinira rad svih ministara/ki.</p> <p>3. Kancelarija premijera se povezuje sa Skupštinom.</p> <p>4. Kancelarija premijera podržava aktivnosti premijera, Vlade, zamenika premijera i ministra i odgovorna je za:</p> <p>4.1 Pripremu i organizovanje sastanaka Vlade i drugih sastanaka kojim predsedava premijer ili jedan od zamenika premijera, u njegovo / njeno ime;</p> <p>4.2 koordinaciju odnosa između Vlade i drugih ustavnih tela (Predsednik, Skupština);</p>



<p>Kuvendit);</p> <p>4.3 koordinimin e ministrive sa ka të bëjë me hartimin e legjislacionit si dhe shqyrton konsistencën me kornizën kushtetuese dhe ligjore si dhe kontrollon cilësinë dhe standardet e hartimit të legjislacionit;</p> <p>4.4 Koordinimin e përgatitjes së prioriteteve strategjike të Qeverisë dhe programit të punës;</p> <p>4.5 Drejtimin dhe koordinimin e marrëdhënieve të Qeverisë me publikun;</p> <p>4.6 Koordinimin e politikave të cilat dorëzohen për miratim në mbledhjen e Qeverisë, si dhe përcaktimin e përputhjes së tyre me prioritetet strategjike;</p> <p>4.7 Drejtimin dhe koordinimin e procesit të monitorimit të zbatimit të vendimeve dhe politikave të Qeverisë;</p> <p>4.8 Ushttrimin e kompetencave dhe funksioneve tjera të cilat i janë caktuar me ligj ose vendim të Kryeministrit ose të Qeverisë.</p>	<p>(President, Assembly);</p> <p>4.3. Coordination of Ministries dealing with drafting of legislation, reviews the consistency with Constitutional and legal framework, controls the quality and standards of legislative drafting;</p> <p>4.4. Coordination of preparation of strategic priorities of the Government and the work program;</p> <p>4.5. Direction and coordination of the Government's relations with the public;</p> <p>4.6. Coordination of policies which shall be submitted for approval at the Government meeting, and determining their compliance with the strategic priorities;</p> <p>4.7. Coordination of the monitoring process of the implementation of the Government decisions and policies;</p> <p>4.8. Exercising the competences and other functions which are assigned by law or decision of the Prime Minister or the Government.</p>	<p>4.3 koordinaciju ministarstava, kada se odnosi na izradu zakona i ispituje usklađenost sa ustavnim i zakonskim okvirom i kontroliše kvalitet i standard izrade nacra zakona;</p> <p>4.4 Koordinacija pripreme strateških prioriteta Vlade i program rada;</p> <p>4.5 Upravlja i koordiniše odnose Vlade sa javnošću;</p> <p>4.6 Vršiti koordinaciju politika koje se podnose za usvajanje na sastanku Vlade i određuju njihovu usklađenost sa strateškim prioritetima;</p> <p>4.7 Vršiti upravljanje i koordinaciju procesa monitoringa implementacije odluka vlade i politike;</p> <p>4.8 Obavlja ostale nadležnosti i funkcije koje su utvrđene zakonom ili odlukom Premijera ili Vlade.</p>
--	--	---



<p>5. Zyra e Kryeministrit përfshin: Kabinetin e Kryeministrit, Zëvendëskryeministrat dhe këshilltaret e tyre si dhe zyrat dhe njësitë që bartin përgjegjësitë dhe funksionet e përcaktuara në Rregulloren për Strukturën dhe Organizimin e Zyrës së Kryeministrit.</p>	<p>5. The Office of the Prime Minister shall include: the Prime Minister's Cabinet, Deputy Prime with Ministers Political Advisors as well as offices or entities having responsibilities and functions under the Regulation on the Structure and Organization of the Office of the Prime Minister.</p>	<p>5. Kancelarija premijera obuhvata Kabinet Premijera, zamenika premiera sa Politički savetnici, kao i kancelarije i jedinice koje snose odgovornosti i funkcije u skladu sa Uredbom o strukturi i organizaciji Kancelarije premijera.</p>
<p>6. Sekretari i përgjithshëm i Zyrës së Kryeministrit është nëpunësi më i lartë civilë në Qeverinë e Republikës së Kosovës dhe është udhëheqësi administrativ i Zyrës së Kryeministrit i cili i raporton drejtpërdrejtë Kryeministrit.</p>	<p>6. The Secretary General of the Office of the Prime Minister is the highest ranking civil servant in the Government of the Republic of Kosovo and is the head administrative of the Office of the Prime Minister who reports directly to the Prime Minister.</p>	<p>6. Generalni sekretar Kancelarije premijera je najviši državni službenik u Vladi Republike Kosova i administrativni je rukovodilac Kancelarije premijera, koji odgovara direktno premijeru.</p>
<p>7. Sekretari i përgjithshëm i Zyrës së Kryeministrit udhëheqë zyrat dhe njësit përkatëse të Zyrës së Kryeministrit në pajtim me Ligjin nr. 03/L-189 për administratën shtetërore të Republikës së Kosovës, Ligjin 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, Rregulloren e punës të Qeverisë së Kosovës, dhe akteve tjera ligjore dhe nënligjore që kanë të bëjnë me sekretarët e përgjithshëm.</p>	<p>7. The Secretary General of the Office of the Prime Minister leads the respective Offices/ Units of the Office of the Prime Minister in accordance with Law nr. 03/L-149 on Civil Servant of the Republic of Kosovo, the Rules of Procedure of the Government, and other legal acts and regulations dealing with general secretaries.</p>	<p>7. Generalni sekretar Kancelarije premijera upravlja odgovarajućim kancelarijama i jedinicama Kancelarije premijera, u skladu sa Zakonom Republike Kosovo br. 03/L-189 za državnu upravu, Zakonom Republike Kosova o civilnoj službi br. 03/L-149, Poslovníkom o radu Vlade i drugim pravnim aktima i propisima koji se odnose na Generalnog sekretara.</p>
<p>8. Struktura dhe organizimi i Zyrës së Kryeministrit përcaktohen me rregullore të veçantë të miratuar nga Qeveria.</p>	<p>8. The Organizational Structure of the Office of the Prime Minister is determined by special regulations approved by the Government.</p>	<p>8. Struktura i organizacija Kancelarije premijera se određuje posebnim propisima usvojenim od strane Vlade.</p>



<b>Neni 17 Ministritë</b>	<b>Article 17 Ministries</b>	<b>Član 17 Ministarstva</b>
